



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.05.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik K.S. Dukagjini SH.A. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare “ , Nr. i prokurimit- 632-24-4721-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik K.S. Dukagjini SH.A. e dt.30.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare “ , Nr. i prokurimit- 632-24-4721-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 29.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 29.05.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik K.S. Dukagjini SH.A. me dt.30.05.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare “ , Nr. i prokurimit- 632-24-4721-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe janë të pakuptimta, sepse Autoriteti kontraktues ka bërë përmirësimin e dosjes duke u bazuar pikërisht në nenet të cilat ju i keni cekur . Ju keni dorëzuar ofertën tuaj pa kaluar afati për sqarime të tenderit dhe neni 53 paragrafi 7 i LPP-së të cilin ju e keni përmendur nuk vlen për rastin tuaj.

Ndryshimet janë bërë konform neni 21 pika 7, e Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, duke përdorur formën B54 siç kërkohet në këtë nen dhe me këto ndryshime nuk është vendosur ndonjë kërkesë e re diskriminuese.

Ju duhet të dorëzoni ofertën tuaj me ndryshimet e bëra duke respektuar afatet ligjore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

